



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM

Dt. 02.09.2021, Nr. 09-M/01-43212



Në bazë të nenit 64 pika 1 e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publikë të Republikës së Kosovës, në vështrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Drejtorati për Arsim në Drenas, shpallë:

KONKURSI BRENDSHËM

1. SHFMU „Gani Sylaj” në Poklek të Ri.
- Një mësimdhënës i Matematikës, më kohë të pacaktuar.
2. SHML „GJ.K.Skënderbeu” në Drenas
- Një mësimdhënës për lënden e Biologjisë, për vitin shkollor 2021 /2022, më mundësi vazhdimi.

KUSHTET E PUNËSIMIT:

Për vendin e punës kërkohet përgatitje adekuate profesionale (me fakultete përkatëse), sipas U.A.05 / 2021 - MASHTI.

Vëmendje!

Kanë të drejtë të aplikojnë vetëm kandidatët të cilët janë mësimdhënës në institucionet arsimore në Drenas.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, patentë shofer ose pasaportë)
3. Diploma origjinale, ose çertifikatën origjinale të diplomimit- jo më të vjetër së gjashtë muaj, e vërtetuar në Komunë - Noteri publik.
4. Vërtetimin që dëshmon që është në marrëdhënie të punës.

REKRUTIMI:

Intervistat me shkrim, me gojë dhe përzgjedhjen e kandidatëve do të bëj komisioni i përzgjedhur nga DKA.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurrim merret në zyrat e DKA-së, të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurimit dhe dokumentet shtesë jashtë dorëzimit në arkiv nuk pranohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Drenas,
Më:02.09.2021



Drejtor për Arsim

Mahamet Gjoka